



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Primjen / Prodato Received / Delivery	22. 08 2022	viti god year	
Organ / Njesia Org / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SMNSHCK	4834/2022		1/5



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.648/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi -Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi anëtarë, si dhe Ilire Mehmeti Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.648/2022 të datës 22.07.2022. të parashtruar nga ankuesja

kundër Vendimit numër të protokollit 480 të datës 04.07.2022 dhe vendimit me numër të protokollit 587 të datës 13.07.2022 të Menaxheres se Burimeve Njerëzore në Komunën e Fushë Kosovës, në çështjen juridike "kontestim konkursi" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 22.08.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.648/2022 e datës 22.07.2022 e parashtruar nga ankuesja

II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër protokollit 587 i datës 13.07.2022 i Menaxheres se Personelit në Komunën e Fushe Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesja ka aplikuar në konkursin e shpallur nga Komuna e Fushe Kosoves, i publikuar sipas njoftimit të datës 16.05.2022, për grupin "Specialit i Administrimit të Përgjithshëm" për pozitën „Zyrtar për Gjendje Civile 1", në Drejtorin e Administratës së Përgjithshme" me numër referencës RN00009038, me datë 17.06.2022. Ankuesja në bazë të Vendimit me numër protokollit 480 të datës 04.07.2022 të Njesisë së Burimeve Njerëzore i është refuzuar aplikacioni për shkak të mos plotësimit të kriterit të konkursit gjegjësisht ankuesja nuk e ka dorëzuar dokumentin me të cilin vërtetohet që nuk është nën hetime.

Ankuesja kundër këtij vendimi, më datë 07.07.2022 ka parashtruar ankesë tek Njësia e Burimeve Njerëzore, ndërsa Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Fushe Kosovës, më datë 13.07.2022 ka nxjerr Vendim me numër protokollit 587 me të cilin ka refuzuar ankesën e ankueses, me arsyetimin se edhe me ankese nuk e ka bashkangjitur dokumentin e munguar e i cili ka qenë kriter në konkursin e publikuar me numër të referencës RN00009038.

Ankuesja, me datë 22.07.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 4259/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër të protokollit 587 me të datës 13.07.2022 të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Fushë Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, konform dispozitive Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 22.07.2022 ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas. Ndërsa Këshilli më datë 04.08.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me Nr.Prot:4259/2022 të datës 22.07.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Dokumentin e identifikimit të ankueses; Ankesën e datës 07.07.2022; Vendimin me numër 480 të datës 04.07.2022 të Menaxheres së Burimeve Njerëzore në Komunën e Fushe Kosovë; Vendimin me numër 587 të datës 13.07.2022 të Menaxheres së Burimeve Njerëzore në Komunën e Fushë Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankese me numër të protokollit 4363/2022 të datës 27.07.2022; Përgjigjen në ankese me numër të protokollit 4522/2022 të datës 04.08.2022; Konkursin me Nr. Reference RN00009038 të datës 16.05.2022 për pozitën "Specialist i Administrimit të Përgjithshëm"; Kërkesën me numër të protokollit 443 të datës 13.05.2022; Verifikimin përfundimtar pas afatit të ankesave për procedurën Specialist i Administrimit të Përgjithshëm të datës 13.07.2022; Verifikimin paraprak të procedurës të datës 04.07.2022; Aplikacionin e ankueses të datës 17.06.2022; Dosja e ankueses: Diplomën e datës 20.06.1996; Diplomën me Nr.1944 të datës 30.12.2008; Vërtetimin e datës 03.03.2008; Letër referencën të datës 04.03.2013; Certifikatën e datës 25.02.2008; Vërtetimin e datës 27.12.2017; Certifikatën e datës 13.09.2011; Kontratën e punës për kohe të caktuar prej datës 11.07.2011 deri me datën 30.03.2012.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha provat e lëndës, konstaton se ankesa e ankueses **është e pabazuar, sepse:**

Ankuesja në ankesën e parashtruar pranë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se gjatë këtij procesi i është mohuar e drejta e përfshirjes në listën e ngushtë, e cila në bazë të shkresave të lëndës konkretisht aplikacionit me datën 17.06.2022 ka aplikuar në konkursin për grupin "Specialit i Administrimit të Përgjithshëm", për pozitën "Zyrtar për Gjendjen Civile 1" në Komunën e Fushe Kosovës i cili konkurs sipas njoftimit të

datës 16.05.2022 ka qenë i hapur nga data 06.06.2022 deri më datën 20.06.2022. Ndërsa Burimet Njerëzore në Komunën e Fushë Kosovës me datën 04.07.2022 kanë marre vendimin me numër 480 me të cilin e kanë refuzuar aplikacionin e ankueses, pasi që e njëjta nuk i plotëson kriteret e konkursit.

Ankuesja e pa kënaqur me vendimin me numër 480 të datës 04.07.2022 lidhur me refuzimin e aplikacionit me datën 07.07.2022 ka parashtruar ankesë pranë Njesisë së Burimeve Njerëzore ndërsa ky i fundit me vendimin me numër 587 të datës 13.07.2022 e ka refuzuar ankesën e ankueses si të pa bazuar.

Kolegji i Këshillit duke ju referuar shkresave të lëndës gjegjësisht konkursit me numër RN00009038, të datës 16.05.2022 për grupin "Specialit i Administrimit të Përgjithshëm" në Komunën e Fushë Kosovës, kërkesë për pranim kanë qenë: *"Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës, Të ketë zotësi të plotë për të vepruar, Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët, Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryere detyrën përkatëse. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje. Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji"*, ndërsa kushtet formale janë kërkuar: *Diploma e studimeve universitare me të paktën 180 kredi/ECTS apo ekuivalente me to, Kualifikime të posaçme formale: Fakulteti Juridik, Administrata Publike si dhe Përvooja e punës nuk është kërkuar.*

Bazuar në provat e administruara të lëndës, të dërguar nga ankuesja dhe institucioni, Kolegji konstaton se ankuesja me rastin e aplikimit përmes sistemit elektronik ka dorëzuar aplikacionin dhe dokumentacionin e bashkangjitur, ku e njëjta posedon Diplomën me Nr. 1944 të lëshuar nga Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" më të cilën dëshmohet që ka përfunduar studimet themelore më datë 15.02.20007 duke marr titullin Juriste e Diplomuar, e njëjta posedon Diplomën e Shkollës së Mesme Ekonomike,, Faik Konica" Ferizaj të datës 20.06.1996 ; Vërtetimin e datës 03.03.2008 të lëshuar nga Qendra Regjionale e Aftësimeve Profesionale-Ferizaj; Letër referencën e datës 04.03.2013 të lëshuar nga Komuna e Ferizajt ; Certifikatën e datës 25.02.2008 me të cilën dëshmohet se ankuesja ka përfunduar Kursin për Teknologji Informative; Vërtetimin e datës 27.12.2017 të lëshuar nga Komuna e Ferizajt me të cilën dëshmohet se ka ankuesja ka qene e angazhuar në punë praktike vullnetare 6 muaj, ndërsa mbi 4 vite e angazhuar me Marrëveshje për Shërbime të Veçanta; Certifikatën e datës 13.09.2011 të lëshuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale me të cilën dëshmohet për kryerjen e programit „Trajnim në punë“; Kontratën e punës të lëshuar nga zyra e Avokat më të cilën dëshmohet se ka kryer praktiken prej datës 11.07.2011 deri me datën 30.03.2012 si dhe Kopjen e Letërnjoftimit të lëshuar nga MPB, si rrjedhojë e kësaj Kolegji, konstaton se ankuesja në aplikacionin e saj të datës 17.06.2022 me rastin e aplikimit për pozitën përkatëse të punës nuk e ka bashkangjitur dëshminë me të cilin vërtetohet se nuk është nën hetime përkatësisht Vërtetimin që nuk është nën hetime të lëshuar nga Gjykata, gjegjësisht ankuesja nuk e ka plotësuar kriterin e konkursit

Sa i përket plotësimit të kriterëve, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, i'u referua Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenit 8 paragrafit 1 nën paragrafit 1.5 ku përcaktohet se *"kërkesat e përgjithshme për pranimin e zyrtarëve publikë përveç tjerash janë: të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre*

penale me dashje", andaj mbi këtë bazë Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se kandidatet për pranim si nëpunës civil faktin që nuk janë të dënuar me aktgjykim të formës së prerë duhet ta dëshmojnë me certifikatë të lëshuar nga gjykata kompetente, e që në rastin konkret bazuar në të gjitha dëshmitë e ofruara si dhe ato të deklaruara nga kandidatja në aplikacion, Kolegji konstaton se kandidatja e lartcekur nuk e ka dëshmuar një gjë të tillë edhe pse është kriterë bazë për pranim të zyrtarëve publikë, konkretisht në këtë rast ankuesja nuk ka dorëzuar dokumentet siç kërkohet edhe me nenin 12 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Andaj, duke u bazuar në faktet e lart cekura konstatohet se Njësia Përgjegjëse, gjegjësisht Njësia e Burimeve Njerëzore në Komunën e Fushë Kosovës bazuar në kompetencat e përcaktuara dhe me nenin 34 paragrafi 6 nën paragrafi 6.1 dhe paragrafi 7 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë si dhe nenin 15 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ka bërë verifikimin paraprak të kandidatëve, ku sipas Vendimit me numër.480 të datës 04.07.2022 ka refuzuar aplikimin e ankuseses për shkak të mos plotësimit të kriterëve.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, lidhur me ligjshmërinë e Vendimit me numër.480 të datës 04.07.2022 të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Fushë Kosovës, ka konstatuar që ky vendim është nxjerr në pajtim me kriteret e përcaktuar në konkurs që të njëjtat janë derivat i kërkesave të përgjithshme për pranimin e zyrtarëve publikë të përcaktuar me nenin 8 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenin 10 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe si rrjedhojë ky vendim është në pajtim me nenin 15 paragrafi 1, 2 dhe 5 të Rregullores (QRK)Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se: *"1.Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidati plotëson kushtet për aplikim. 2.Verifikimi paraprak kryhet nga Njësia Përgjegjëse, në bazë të dokumenteve të paraqitura si pjesë e aplikimit dhe verifikimeve të tjera sipas detyrës zyrtare që ndërlidhen me verifikimin paraprak.... 5.Kandidatë, që nuk plotësojnë kushtet për aplikim në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, nuk kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurimin. Vendimi për mosplotësimin e kushteve për aplikim, arsyetohet dhe u njoftohet individualisht aplikantëve..."*.

Njësia e Burimeve Njerëzore Komunës së Fushë Kosovës, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër protokolli 587 mbi refuzimin e ankesës së ankuseses të datës 13.07.2022, ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.6/L-114 për Zyrtarët Publikë, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën Administrative dhe Rregulloren (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, duke vërtetuar gjendjen faktike dhe bazën juridike, lidhur me refuzimin e aplikacionit të ankuseses për grupin *"Specialit i Administrimit të Përgjithshëm"* për pozitën *"Zyrtar për Gjendjen Civile 1"* në Komunën e Fushe Kosovës.

Ashtu siç u tha me sipër, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe nenin vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda: A.nr.648/2022

Ilire Mehmeti -SHAQIRI


Procesmbajtëse

Malsore Gashi Bajraktari


Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Fushë Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Fushë Kosovës;
- Arkivit të KPMSHCK- së.

